

VENDIM
Nr. 61, datë 14.12.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E NORMËS SË INTERESIT PËR KTHIMIN E NDIHMËS
SHTETËRORE PËR VITET 2010–2015**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Z. Arben Ahmetaj kryetar
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Znj. Anduena Dedja anëtar.

Në mbështetje të nenit 17, shkronja “d”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar dhe të nenit 15 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005,

VËREN SE:

1. Në nenin 27, të ligjit nr. 9374, datë 21.4. 2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe nenet 15 dhe 16, të rregullores “Për procedurat dhe format e njoftimit”, jepet metoda e përcaktimit të normave të interesit për kthimin e ndihmës shtetërore.

2. Komisioni i Ndihmës Shtetërore ngarkohet të shpallë normën në fuqi të interesit, si dhe rillogaritjet, nëse janë të nevojshme.

3. Norma e interesit llogaritet në bazë të mesatares së normës TRIBOR për muajt shtator, tetor, nëntor të vitit paraardhës, duke i shtuar edhe 0.75 për qind.

4. TRIBOR (Tirana Interbank Offer) përcaktohet sipas rregullores “Mbi llogaritjen e normave fikse të interesit në tregun ndërbankar të parasë”, miratuar me vendim nr. 99, datë 27.12.2006, të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 17, shkronja “d”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e normës së interesit për kthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme, për periudhën 2010 deri në 31.12.2015, si më poshtë:

- a) Për vitin 2010 = 10.2%;
- b) Për vitin 2011 = 9.07%;
- c) Për vitin 2012 = 8.88%;
- d) Për vitin 2013 = 8.43%;
- e) Për vitin 2014 = 6.46%;
- f) Për vitin 2015 = 4.59%.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ahmetaj